

# PIKËPAMJE LEKSIKO-FRAZEOSTILISTIKE TË POEMAVE JOSONETIKE TË MJEDËS

Zenun GJOCAJ

Aftësia e rrallë krijuese poetike me një strukturë të gjërë e të thellë sa leksiko-semantike, aq edhe stilistike përmes një individualiteti krijues, i bëri Mjedës emër të përjetshëm në letërsinë shqipe, sidomos me poemat patriotike e refleksive, brumosur me elemente autobiografike e filozofike.

Me gjithë kontrastet, përmes gjuhës së figurshme, simbolit dhe alegorisë, si pjesë organike të poemave, shquhet (dis)harmonia krahasore e natyrës reale dhe asaj të imagjinuar, e brendshme me realitetin objektiv, e metaforës jetësore, prej nga varet pësha leksiko-semantike e stilemave, e fjalës dhe e togfjalëshit në shërbim të stilit, si mjete shprehëse psiko-socio-gjuhësore të botës së brendshme të poetit, personazheve dhe fatit njerëzor në rrethana të veçanta.

Me ndryshim nga poetët e tjerë të kohës, Mjeda shquhet nga shumëkuptimësia e fjalës, thellësia e shprehjes dhe e koncizitetit, në përgjithësi ekonomizimi i gjuhës në shërbim të simbolikës, metaforës, anaforës, epitetit etj. Kështu, disa simboleve të njëjta të përdorura nga bashkëkohësit si *lejleku*,

*bilbili*, *dallëndyshja*, u ka dhënë konotacione me strukturë më të gjerë e më të thelluar kuptimore e stilistike, duke i bërë kështu edhe poemat të një peshe e të një niveli më cilësor. Për t'i realizuar synimet poetike, në vargun e vet, mbledh tema, ide, mendime, figura (fjalë, leksema, semantema, stilema, frazeologji etj.).<sup>1</sup> Në dallim nga bashkëkohësit, figurshmëria e fjalëve të tij në shërbim të stilistikës ka një jehonë më të gjatë, më të fuqishme e më të kumbueshme, si tingëllima e një këmbane cilësore. Madje, edhe leksiku tipik malësor: *pemët*, *lisat*, *bagëtia*, *gurra*, *bulku*, *qengji*, *plehu*, *mjelca*, *tambli*, *ograjat*, *krandet*, *bleta*, *zgjoi*, *sovajka*, *shpata*, *cirliku*, *shllunga*, *përsheshi me kallamboçe* / *i mirë edhe për zotnij*, Mjeda i universalizoi, edhe pse disa sosh, sot, trajtohen si arkaizma apo nëndialektizma, madje edhe lokalizma, por jashtë përdorimit artistik.

*Trinitë semanto-stilistike, si mjete shprehëse poetike e jetësore.* Vlen të theksohet se tri poemat psiko-sociale të Mjedës përshkohen nga triniteti tërësisht e pjesërisht jetësor, së pari

të vetë atij, si student i kolegjit fetar të tipit të mbyllur, për çka u motivua për shkrimin e poemës *Vaji i bylbylit*, më vonë si i arrestuar, për çka u motivua për shkrimin e poemës *I tretuni* dhe së fundi si prift i mbyllur në kishë, sidomos në atë të Kuklit plot 25 vite me radhë, prej nga gjason të motivohet dhe të frymëzohet për hartimin e një tragjike vetmore të një familjeje tipike malësore, të një nëne me dy vajza, pa një mashkull, qoftë edhe plak, apo fëmijë, të titulluar *Andrra e jetës*. Këto trini rrjedhin nga koncepti i fatit jetësor të poetit – vetmisë, që e përcjell tërë jetën si student, më vonë prift, krijues letrar e shkencor me disa përjashtime. Mbi këtë trini u motivua për hartimin e tri poemave të sipërshënuara. Edhe së brendshmi, poemat përshkohen nga trinitë e nëntrinitë leksemantike: E para përshkohet nga dy dimrat (I dhe II) të të njëjtës kohë dhe të një shprese optimiste – të një pranvere të bazuar në dialektikë:

I. Bora po shkrihet / *Dimni* po shkon

/ *Bylbyl* i vorfën / Pse po gjimon (I)

II. Por vaj se'j *dimën* tjetër / Paskë o *bylbyl* i shkreti (II)

III. Mbas boret t'*dimnit* çilet **pranvera**... / ...*Bylbyl* ky shekull / or' e ças ndërrohet... / *Fillo me gëzue* (V)

Ngarkesa e bylbylit të dimrit “*të parë*” e “*të dytë*”, për të cilët studiuesit nuk lidhen në një hu, duke i nxjerrë si simbole herë të poetit, herë të atdheut, del një i tretë që i shkrin në një të vetëm, ku poeti I jep zemër bilbilit, se

*Krajlnitë ma t'moçme ndërrohen me të reja ... erdh pranvera / Fillo me gëzue*. Me konceptime të tilla të reja e të freskëta, me peshë të gjerë e të thelluar semanto-stilistike, Mjeda shkoqet nga niveli artistik tradicional dhe solli freski në letërsi bashkëkohore, duke hapur rrugë të mëtejme të letërsisë bashkëkohore. Ndryshe nga dy leksemat e para të trinisë, të shprehura me fjalën *dimer* (I dhe II), ku poeti, herë atdheu i mbyllur në kafaz shërbehet me ndjenja, në trininë e tretë të të njëjtit bilbil, ardhmërisë së bilbilit Mjeda i jep zemër më tepër me mend e me fakte dialektike të argumentuara me ndërrimin e stinëve, moteve, shekujve, krajlnive e shtresave shoqërore, të simbolizuar me bilbil e pranverë, që e mbyll rrethin vicioz të përputhur me fillimin e poemës: *Po shkrihet bora...A çilë kafazi...* dhe në fund: “*Mbas boret t'dimnit çilet prandoera...*” Do të shtonim se trinia jetësore, fetare e krijuese e Mjedës mishërohet edhe në vepra, që i japin tonin e një filozofie jetësore të përgjithshme atëherë aktuale, përzier me elemente autobiografike, sidomos në tri poemat psiko-sociale e në disa poezi të ngjashme si “*Malli për atdhe*”, “*Shtegtari*”, “*Po shkon me bujt te Zoja*” etj. Kjo e fundit, e shkruar më 1990, më vonë u bë pjesë organike e poemës “*Andrra e jetës*” e nominuar si *Trina*. Megjithatë, sipas disa studiuesve, për Mjedën, poezia ishte zgjidhje spontane e problemeve të tij vetjake, me të cilat synoi kryesisht kombëtarin,<sup>2</sup> më rrallë të

përgjithshmen njerëzore, si të “*Andrra e jetës*”. Ishte jo Mjeda që shihej, por ai i brendshmi, subjektivi, kryengritësi ndaj padrejtësive e ligjësive shoqërore e përgjithësisht natyrore. Dukuritë e tilla i karakterizojnë leksemat e stilemat e poemave.

Të gjitha poemat lirike psiko-sociale me ndonjë poezi të karakterit të tillë, e kanë një të përbashkët: vetminë e poetit. Fatkeqësia e tij buron nga fatkeqësia e atdheut të robëruar, por del edhe jashtë kësaj fatkeqësie subjektivistike, duke qëndisur tani një vetmi familjare, të ndrydhur nën peshën e ligjeve të egra malësore, ku femra vuan nga inferioriteti (*Andrra e jetës*)

Te poema *I tretuni* trinia është më e zbehtë, por pak a shumë e përvijuar. I arrestuari dhe i larguari nga atdheu, i burgosuri i mbërthyer nga hekurat i kapluar nga ëndërrat shpërthen me tone herë melankolike, herë të ashpra, të shkallëzuar deri në mallkim (*Veshknju lule...*), për të zbritur në ngjyime emocionale të buta në formë urimi (*Por, ju dele... shtonju, shtonju e larg m'i çoni / për tregtarë do bashka lesh*) herë në ëndërr, herë në zhgëndërr drejtuar nënës dhe atdheut, me të cilat kalon motin. Është një temë e re në letërsinë shqipe të deriatëhershme, me ngjyime të veçanta edhe të mëpastajme që e pasuroi letërsinë në përgjithësi. Pjesa e parë është karakteristike me ashpërsi të natyrës, nga shkaku i largimit nga vendlindja e atdheut, atëherë e shkruar në Kraljevicë<sup>3</sup>, përzier me mall, si shpërthim i ashpër-

sisë së mllefrit të natyrës subjektive të poetit. Stilemat: *shiu, stuhia e bjeshkëve dhe e maleve me re, ujët e përvëlur të detit, zdatat, rrëfeja, gjama e natyrës*, në krahasim me *vajin*, përballë mallit për *Shkodrën, Buenën, Cukalin, Drinin, nënën, lulet, zogjët, grurin, delet, lisat*, si mjete stilistike për karakterizimin e botës subjektive të mllefosur, të radhitura sipas logjikës e rëndësisë shpirtërore të poetit, poezisë shqipe i kanë dhënë një strukturë të re poetike më të thelluar e më energjike, ndryshe nga përshkrimi i mërgimit nga shkrimtarët të kohës. Pjesa e dytë karakterizohet nga *terri i shpellës, hekurat e shtërngueshëm, vaji e trishtimi*, “*gjama e nji t’shkret i / qi merr vala e detit*”. Ndërkaq, pjesa e tretë (kënga V) karakterizohet nga ëndrra për nënën e përbotur me këshillat e veta, drejtuar të birit të burgosur dhe të mërguar. Është një bisedë imagjinare e të treturit me lejlekun / atdheun, me nënën... që sjell një fond të veçantë stilemas me karakter patriotik: “*Një nanë tjetër thoshe ke / bir n’at dhe / nana jote a Shqyptaria... Nam e zemrë për te shkrij / E përtriji / Nam e lavd kur t’ovinë dita*”... *Mbas fjalësh t’ua për here shkova / E t’ndigjova / Shqiptarinë nuk e korita*.” E gjithë poema rezulton me trininë paralele: *trishtimi i papritur-gumëzhitja e prangave-ëndërra*. Në shkretëtirë, ku dergjet në burg i *treturi*, nuk shëndrit dielli, nuk gjallojnë bilbilat, as lulet. Trinia e tillë semantike nuk është e rastësishme. Dielli si burim i jetës së çdo bime e frymori në tokë është i domosdoshëm për gjallërimin e dy të tjerave, si semantema

poetike, karakteristike për të gjithë poetët e kohës.

### Trinomia te “Andrra e jetës”

Vetë zgjatja e kohës së hartimit të poemës “Andrra e jetës” dëshmon për stilin e gjuhën e ngjeshur tek kryevepra e Mjedës, një ndër kryeveprat e letërsisë shqipe të këtij lloji. Jo rastësisht *Andrra e jetës* së pari ndërtohet nga trinomi **Trina-Zoga-Lokja** e disa trini, si degë e pipa të një peme filozofike jetësore: *lindja-jeta-vdekja; femënia-rinia-pleqëria; lule e këputur që në fillim (Trina) - lule e vishkur (Lokja) - lule e përtërirë (Zoga); pranvera-vera-vjeshta me dimër; jetë e papërrjetuar (Trina)- e përjetuar dhe dhimbshëm e përfunduar (Lokja) - e përtërirë përmes trashëgimisë (Zogës s’i ndodhi si Lokes, t’i vdesë burri pa i lënë djalë; nënë bardha-nënë zeza-nënë shkreta (me krye vjerrë).* Këto procese poetiko-filozofike: *pranvera (rinia) - vera e frytshme (përtërirja e Zogës) dhe vjeshta (pleqëria) përfundojnë me dimrin (vdekjen fatkeqe të Lokes), që s’do të thotë se nuk e pret edhe Zogën, por jo të vetmuar, sepse trashëgohet nga një djalë - kontekst i nënkuptuar, anipse studiuesit janë hutuar me ëndrrën e Zogës në fillim që i paraprin dhe e alarmon realitetin. Kështu, secila prej tri pjesëve trinomike e trinike jetësore-poetike përfaqësojnë një kohë e një përfundim të veçantë të jetës njerëzore.<sup>4</sup>*

Përgjithësimin e kuptimeve gjuhësore, poetike dhe jetësore e bëjnë simbolet: *bylbyli, dallëndyshja, plori, përroi,*

*lumi, lisi, qiparisi, mollat, mordja, Zoja, era, krizantemi, çerdhja, makthi etj.* Poema *Andrra e jetës* është metaforë e jetës,<sup>5</sup> e cila si metaforë më vete, ndërtohet mbi metafora më të vogla: *jetë e këputur në lule të rinisë-jetë e vyshkur-jetë e përtërirë.* Mjeda, sado që është poet i mirëfilltë më tepër lirik se epik, ndryshe nga Fishta, mjaft epik (me “*Lahutën e Malcis*”), e nga Lasgushi, mjaft lirik, i shfrytëzoi me masë të mjaftueshme elementet mbishtesore mbisemantike shprehëse, emocionale e stilistike, karakteristike për gjuhën popullore. Aristokrat për nga stili, ishte popullor për nga mesazhet, personazhet i vë në rrafshin e një realiteti ahistorik e ageograf,<sup>6</sup> sado që analiza etno-psiko-sociale e poemës do të na shpjegë në një region malor të shtërnguar me ligje specifike kanonore, ku femra ndrydhet nën peshën e rëndë të këtyre ligjeve. Shprehësia konotative e vargjeve të lirikës popullore e shteruar edhe në epiko-lirikën shqipe, sidomos të asaj kohe, pos te Migjeni, i rrit aftësitë shënuese.

Sinonimet në poema janë të dendura dhe të larmishme, në raport me njësitë leksiko-semantike **fjalë-fjalë**: *mblojnë e veshin (at lendinë); çika-goca-vasha; mali-pylli; vetun zbardhet e vetun erret; fjalë-frazeologji: qi t’knaq e qi t’ban rob; mbas bores blerimi del; po një lule / qi kish bi / përmidis zemrës sate; aj lejlek e u falte nderës; e disprohet ke i vë mendja; frazeologji-frazeologji: molla t’këputuna në një degë / dy qërshia lidh n’një rfanë; tui kqyr me zemër t’plasun*

*/iu mbushën sytë me lot; a tue ndrrue mot/se a tue çue nji tjetër erë, por edhe antonime frazeologjike; ku qeshet kopshiti / idhnim mos mba; o t'vinë t'floitit, o t'vinë t'xetit / vaji zemrën ja pëlçet*

Një strukturë e vçantë sintagmatike formohet me shkallëzimin: togfjalësh i lirë (jetë e vështirë) – frazeologji letrare të fazës kalimtare: *se në pemët kanë endun lulet “lulëzuar” / u vesh fusha me blerim “bleroi” - frazeologji (fat i zi) – frazeokompozitë (fatzi); ...Me krye n'hi e shuenja plakë / Ia kish njomë atë bukë e mjera*. Poemat kanë edhe figura të tjera stilistike, si epiteti, krahasimi, similitude etj.

Dihet se frazeologjia është bartëse e fuqishme e figurshmërisë. Ajo e mundëson krijimin e shumë stilemave togfjalëshore si pjesë e organizimit stilistik. Frazeologjitë tipike të gjuhës popullore i shërbejnë Mjedës për të ndërtuar figura stilistike të ndryshme në rrethana kontekstuale e situative, të cilat e shtojnë efektin poetik në gjerësi e thellësi meditative: *“Ngre bylbyl n'at hije valle (=vallëzo);“Tirte me zemër t' plasun”* (mjaft e dëshpruar); *zemra me mall gazmohet; ke i ve mendja; e lshon gjetht qi para pat; njat idhnim, qi t'u ba helm (= të helmoi); me dijt hyjt me bisedue / me pasë sy qi me derdh lot (=me qajtë)*. Ka edhe frazeologji krahasore: *“N'për ograjë po këndojnë bylbylat / si tue prallë me shoqishojnë* (fantazuar); *gurra e lugut veç ushtote / si lahutë me kangë kreshnike; u ndie'j frymë... / porsi erë qi vjen pa shkas*; Fjalët janë në shërbim

të semantostilistikës: *vdekja, martesë, pleqëria, hareja, dëshprimi, furtuna, kafshët, bukuritë e natyrës malësore nën trysinë e fatit të zi jetësor; gurra, bleta, lulet, bilbili dallëndyshja, hyjzit, përroi, vesa, votra, rrezet, dielli, dimri, bora, mordja etj*. Pos Migjenit, ndryshe nga bashkëkohësit, Shirokës, Fishtës, pjesërisht edhe Gurakuqit, Mosit, Siliqit e ndonjë tjetri, figurshmëria leksikostilistike e Mjedës ka jehonë më të gjatë tingëlluese, si tingëllima e një metali të vlershëm, me të cilat formon një realitet poetik të krijuar nga mendja, në dobi të kursimit të emocioneve, përzier me realitetin e subjektivizuar.<sup>7</sup>

#### Antitezat poetike

Pos trinomisë (Irina-Lokja- Zoga) e trinive të shumta, *Andrra e jetës* ka edhe antiteza të ndryshme, mbi të cilat ndërtohet poema, por jo vetëm bardhezi, gjë që e ngrit cilësinë artistike të poemës: *lindja-jeta-vdekja, femënia-rinia-pleqëria; fati i bardhë (Zoga)-fati i zi (Lokja)-fati i papërjetuar/i këputur* (Irina, sepse nuk e përjetoi jetën e zezë të Lokes, as lumturinë e Zogës). Këto procese poetike-filozofike përshkohen dhe gërshetohen me antiteza të shprehura me kontraste të skajshme: *pranvera (rinia e hershme) – dimri (vdekja); vaji – gëzimi, ëndrra – realiteti / zhgëndrra; dhuntia e natyrës – dhuna mbi fatin e familjes, gjithnjë, si në poemat e tjera lirike të mëparme (Vaji i bylbylit dhe I tretuni), të përmyllura me optimizëm apo me krenari: “Mbas borës blerimi del” etj. Përmes kontrasteve for-*

mohet antiteza artistike: *jetë-vdekje, jetë e bardhë-jetë e zezë; rini-pleqëri; ëndërr-re-alitet; pran/verë-vjeshtë/dimer; mot i mirë-mot i lig.*

Përgjithësisht, Mjeda është ndër të rrallët që shkriu jetën me natyrën, përjetimet shpirtërore me rrethanat kohore, me elementet biografike e përgjithësisht jetësore, hidhërimet me tendencat për optimizëm në bazë të dialektikës, më tepër se të fenomeneve mbinatyrore, elementet leksiko-semantike e sintagmatike të qëndrueshme me figurat stilistike, strukturën stilistiko-semantike të gjerë dhe të thellë kuptimore të intensitetit të ndryshëm. Te *Andrra e jetës*, më tepër se në poemat e tjera me elemente autobiografike, ka fjalë e shprehje të kursyera, gjë që e bën stilin konciz, sidomos te *Zoga*. Konciziteti dhe shprehësia e kursyer e mbarë poemës e ka bërë të mundshme edhe kursimin e anaforës asociative, e cila luan rol qendror në organizimin e tekstit dhe në realizimin e koherencës së tij, si shënues referencial. Bien në sy përpjekjet puriste gjuhësore në shërbim të efektit stilistik të vargut, të gjerësisë e thellësisë kuptimore e figurative. Detaji te Mjeda nuk është stoli e jashtë, por pjesë organike e domethënies së gjithë veprës: natyrës, shpirtit, personazheve, si mjet i fuqishëm shprehës artistik i natyrshëm e i logjikshëm. Fjalët shpesh janë në funksion portretizues të personazheve.<sup>8</sup> Derisa te poezia *Malli për atdhe* e te poema *I treturi mallkon lulet, zogjtë, grurin, përkundër*

etikës fetare, tek *Shtegtari* vrapon drejt atdheut, ndërsa te *Po shkon me bujtë te Zoja*, shkon drejt vdekjes. Kështu, mërgimi te Mjeda merr formën e një pakënaqësie shpërthyesë, sadoqë, studiuesit në këtë pikëpamje paksa e kanë fryrë,<sup>9</sup> sepse kjo pakënaqësi bie shkallë-shkallë, madje deri në falimentim të skajshëm jetësor, si te *Andrra e jetës*, me vdekjen e Lokes në pikë të dimrit. Këto përplasje psiko-poetike i kanë detyruar studiuesit që t'i analizojnë raportet e N. Mjedës si patriot, fetar, politikan, luftëtar, studiues, poet etj., prej nga rrjedh se ai më tepër është human, patriot, politikan, shkrimtar/studiues, se fetar.<sup>10</sup> Megjithatë, vlerat gjuhësore e stilistike i siguruan Mjedës vend të merituar e të përjetshëm në letërsi.

### Shënime

1. M. Quku, *Mjeda 2*, Tiranë 2006, f. 413
2. M. Quku, vep. e cit., f. 35
3. Po aty, f. 198 *Po shkon me bujtë te Zoja*, si poezi, u shkrua më 1890, ndërsa *Andrra e jetës* filloi të shkruhet më 1904
4. Po aty, f. 453
5. R. Qosja, *Historia e Letërsisë II – Romantizmi*, Prishtinë 19... f. 461
6. M. Quku, vep. e cit. f. 35
7. A. Berisha, *Andrra e jetës*, Prishtinë 2005, Parathënie
8. M. Gurakuqi, *Veçori të artit të Mjedës*, në Studime për letërsinë shqipe I, T. 1981, f. 451
9. M. Quku, *Mjeda 2*, f. 55.
10. M. Quku, *Mjeda 2*, f. 406